


5.1 RIFINITURA

FINO CLASSIC



Njësia matëse	copë/kuti	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes 5 kg/qese	54 cp/paletë 4 cp/kuti	2-2.3kg/m ²	Gri E Bardhë



FINO CLASSIC

Është material në formë pluhuri i prodhuar në bazë të teknologjisë HTT (Harman Transpirance Tecnology) që parandalon krijimin e mykut dhe lejon transpirimin e murit me bazë çimentoje, gëlqereje të hidratuar, rëre guri karbonik dhe mermeri me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditivë special.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Karakterizohet nga hapje dhe punueshmëri mjaft e mirë, mbulueshmëri shumë e lartë (10 - 12 m² / thes 25 Kg)
- Lehtëson aplikimin në sipërfaqe të jashtme edhe të brendshme të mbushura si me laç tradicional ashtu edhe me laç të parapërgatitur.
- E aplikueshme në një trashësi deri në 3 mm.

FUSHAT E APLIKIMIT

I përshtatshëm për realizimin e rifiniturave të sipërfaqeve të mbushura me laç tradicional ose me laç të parapërgatitur me bazë çimento - gëlqere. Mund të mbulohet me bojë, ose me veshje të tjera me natyrë minerale dhe sintetike.

TË DHËNA TË RËNDËSISHME

- Nuk duhet të shtohen komponentë të tjerë si çimento, gëlqere etj, në produktin e dhënë.
- Nuk duhet të aplikohet mbi sipërfaqe të lyera më parë.
- Nuk duhet të aplikohet mbi sipërfaqe apo mbi veshje plastike.
- Nuk duhet të aplikohet në sipërfaqe me trashësi më të madhe se 3 mm.
- Nuk duhet të shtohet ujë mbasi përbërja është përgatitur.
- Duhet të aplikohet në temperatura nga +5°C deri +35°C.
- Nuk duhet të aplikohet në vende ku ka veshje prej qeramike.
- Nuk duhet të aplikohet në sipërfaqe me bazë gipsi.
- Nuk duhet të aplikohet mbi sipërfaqe lehtësisht të thyeshme apo të shkatërruara.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Sipërfaqja apo suporti ku do të vendoset FINO CLASSIC duhet të jetë e niveluar dhe e qëndrueshme. Sipërfaqet me disnivel më të madh se 3 mm duhet të nivelohen përpara aplikimit të produktit.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Në një enë hidhni 7.5 - 8 litra ujë dhe 25 Kg Fino Classic. Përzijeni me një përzierës elektrik me numër të vogël rrotullimesh derisa masa të bëhet homogjene. Për të stimuluar karakteristikat e përzierjes dhe për të pasur një rezultat sa më të mirë rekomandohet që përzierja të lihet në qetësi rreth 10 minuta dhe të trazohet përsëri përpara përdorimit.

MËNYRA E APLIKIMIT TË PRODUKTIT

Materiali duhet të përhapet me një mallë metalike duke siguruar një shtresë uniforme në të gjithë sipërfaqen. Dora e dytë e materialit duhet të aplikohet 30 minuta mbas aplikimit të dorës së parë. Pasi arrihet tharja e duhur rreth 15 minuta në temperaturë 23°C sipërfaqja duhet fërkuar me përdaf. Temperatura e ambientit ndikon ndjeshëm në kohën e punueshmërisë së produktit. Sa më e ulët të jetë temperatura aq më shumë zgjatet koha e punueshmërisë.

MËNYRA E PASTRIMIT

Veglat e punës dhe duart duhet të pastrohen deri kur produkti është ende i njomë.



TË DHËNA TEKNIKE

	7.5 - 8litra ujë për
Raporti i Përzierjes	25 Kg Fino të
	E Bardhë/Gri
Koha e punueshmërisë	3 - 4 orë
Temperatura e aplikimit	Nga +5°C deri +35°C
pH i përzierjes	12
Trashësia për dorë	2 mm
Koha e pritjes për aplikimin e dorës së dytë	30 - 40 min
Koha e pritjes deri në fërkim	15 - 20 min
Koha e pritjes për lyerjen e sipërfaqes	3 - 4 javë

TË DHËNA TEKNIKE (NË 23°C DHE 50% U.R)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri/E Bardhë
Ruatja	12 muaj në paketim original në vend të thatë
Djegshmëria	I padjegshëm

TË DHËNA PËRFUMDIMTARE

Rezistenca në shtypje mbas 28 ditëve	≥ 5 Nmm ²
Rezistenca në përkulje mbas 28 ditëve	≥ 2.5 Nmm ²

